



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri

PROCESVERBAL

nga konsultimi publik për Draft-Kodin e Etikës , mbajtur më 20 nëntor 2024 në sallën e kuvendit të komunës, i cili filloi në ora 11:00.

Komuna e Vushtrrisë ka mbajtur konsultim publik, ku është diskutuar Draft – Kodi i Etikës.

Të pranishëm ishin anëtarët e komisionit: Bislim Dushi (kryesues), Xhavit Mehmeti (anëtar) dhe Bujar Klinaku (anëtar).

Bislim Dushi, kryesues i komisionit, e hapi dhe e kryesoi takimin, i cili prezantoi punën e komisionit për hartimin e Draft – Kodit të Etikës. Ai tha se janë bërë disa ndryshime nga kodi paraprak i vitit 2020. Dushi deklaroi se ky draft është në konsultim publik deri më datën 2 dhjetor. Andaj, ju jemi mirënjohës si komision që t'i paraqitni vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e juaja. Ato propozime që janë të arsyeshme do t'i përfshijmë në draft.

Gjylsime Feka, zyrtare e komunës, e përgëzoi komisionin për hartimin e Draft-Kodit të Etikës. Ajo tha se te neni 16 ndoshta është dashur të shtohet ndonjë paragraf që: shërbyesit civilë mos të bëjnë fushatë zgjedhore në institucion ose jashtë tij, në mënyrë që mos ta shfrytëzojnë pozitën e tyre të punës për fushatë zgjedhore.

Liridon Lahu, zyrtar i komunës, kërkoi që paragrafi 4 i nenit 25 të riformulohet si në vijim: “Pas përfundimit të marrëdhënies së punës duhet të dorëzohen pasuritë që i ka pasur në disponim, duke respektuar procedurat e aktit të brendshëm (Rregulla për menaxhimin e pasurisë jofinanciare të komunës). Ndërsa, te ky nen të shtohen këta paragrafë:

25.5 Duhet t'i dorëzojë të gjitha kredencialet e sistemeve të teknologjisë informative që ka pasur në administrim;

25.6 Duhet t'i mbyllën të gjitha llogaritë elektronike që ka pasur gjatë kryerjes së detyrës zyrtare;

25.7 Të gjitha dokumentet fizike dhe elektronike që ka krijuar gjatë kryerjes së detyrave të punës janë pronë e komunës dhe duhet të dorëzohen me rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës.

Ai tha se pse te neni 17 kërkohet që të bëhen publike shpenzimet gjatë fushatës zgjedhore të kandidatëve.

Bislim Dushi, kryesues i komisionit, sqaroi se nenin 17, i cili parasheh që të publikohen shpenzimet e kandidatëve gjatë fushatës, këtë e ka kërkuar sponsorizuesi për shkak të transparencës.

Jeton Salihu, zyrtar i komunës, te neni 28 të shtohet një paragraf që ndërlidhet Ligjin Nr. 06/L -011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si në vijim: “Zyrtarët e lartë (Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës, Kryesuesi/ja i Kuvendit dhe Drejtorët e Drejtorive) nuk kanë të drejtë të krijojnë marrëdhënie pune për një periudhë dyvjeçare në administratë, shëndetësi dhe arsim.

Xhavit Mehmeti, anëtar i komisionit, tha se ky dokument është unik në tërë Kosovën. Ai tha se është mirë që pas miratimit të Kodit të Etikës të krijohen kushte për zbatimin e tij. Ndoshta është mirë që të krijohet një grup punues apo një ekip i zyrtarëve që do të merreshin me trajnimin dhe sqarimet eventuale për zyrtarët.

Takimi përfundoi në ora 11:45.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku

Procesmbajtës

